Sekretariati Shqiptar EITI

RAPORTI VJETOR I AKTIVITETEVE EITI 2013

Përgatitur nga:

EITI – Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse

Maj, 2014

Tabela e Përmbajtjes

1 NJE VLERESIM I PERGJITHSHEM I PERFORMANCES VJETORE 3

2 VLERESIMI I PERFORMANCES KUNDREJT OBJEKTIVAVE DHE AKTIVITETEVE TE PERCAKTUARA NE PLANIN E PUNES 4

2.1 OBJEKTIVI 1: ANTARSIMI DHE VAZHDIMESIA E SHQIPERISE NE STRUKTUREN NDERKOMBETARE EITI ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

2.2 OBJEKTIVI 2: RAPORTI EITI PER VITIN 2011 ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

2.3 OBJEKTIVI 3: NGRITJA E KAPACITETEVE ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

2.4 OBJEKTIVI 4: SHTRIRJA E IMPAKTIT EITI NE SHQIPERI, AKTIVITETET E KOMUNIKIMIT ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

2.5 OBJEKTIVI 5: AKTIVITETE LIDHUR ME SIGURIMIN E FONDEVE ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

3 VLERESIMI I PERFORMANCES KUNDREJT KERKESAVE EITI ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

4 PERMBLEDHJE E PERGJIGJEVE TE MSG PER REKOMANDIMET NGA RAKORDIMI DHE VALIDIMI, NESE ESHTE E APLIKUESHME ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

5 NDONJE PIKE E FORTE OSE DOBESITE E IDENTIFIKUARA NE PROCESIN EITI*ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.*

6 KOSTOJA TOTALE E IMPLEMENTIMIT ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

7 NDONJE KOMENT SHTESE ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

8 ESHTE DISKUTUAR VEPRIMTARIA E RAPORTIT PERTEJ MSG-SE 16

9 DETAJE MBI ANTARESINE E MSG GJATE PERIUDHES ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

SHTOJCE: FOTO TE AKTIVITETEVE TE EITI-IT SHQIPTAR NE 2013 ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

1 Një vlerësim i përgjithshëm i performancës vjetore

Shqipëria është një vend i pasur me minerale dhe ka potencial të konsiderueshëm të zbulimit të naftës dhe gazit. Sektorit të industrisë nxjerrëse, sot po i jepet një rëndësi prioritare për zhvillimin ekonomik të vendit, si një kontribues në makro-ekonominë e vendit, në zhvillimin e komuniteteve lokale dhe në punësim. Shqipëria është e njohur për rezervat e kromit, bakrit dhe nikelit dhe është një qendër e rëndësishme për burimet e hidrokarbureve në zonën Mesdhetare.

Pasi vlerësoi performancën e Sekretariatit Shqiptar EITI nëpërmjet publikimit të raporteve të para EITI 2009 dhe EITI 2010 dhe proçesin e pare të Validimit 2011, Bordi Ndërkombëtar EITI, e shpalli Shqipërinë më 2 maj 2013 “Vend Zbatues EITI”.

Përmirësimi i menaxhimit të industrisë nxjerrëse ishte në fokusin e Konferencës së 6 Globale EITI në Sidnej, ku Shqipëria merr pjesë për herë të parë si një vend antar i nismës EITI. Zgjedhjet qëndrore në qershor 2013, shkaktuan ngrirjen e administratës publike duke ndikuar edhe në veprimtarinë e Sekretariatit Shqiptar EITI. Mungesa e fondeve ndikoi në mos realizimin e aktiviteteve2013. Shqipëria nuk realizoi publikimin e Raportit 2011 brënda vitit 2013. Sekretariati Shqiptar EITI shprehu shqetësimin pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe Bankës Botërore për aprovimin e menjëhershëm të marrëveshjes grand “*Mbështetje të Zbatimit Shqiptar EITI për periudhat 2014-2015*".

Në Shtator 2013 me strukturën e re qeverisëse u krijua Ministria e Energjisë dhe Industrisë e cila u disenjua si institucioni i cili mbikqyr industrinë nxjerrëse në vend dhe të gjitha veprimtaritë e lidhura me të. Që nga ky moment, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka ndërmarr një rol kyç dhe proaktiv për promovimin dhe mbështetjen e të gjitha aktiviteteve të

Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse. Në Nëntor të 2013 rifilluan mbledhjet e MSG për veprimtarinë EITI. Zëvendës Ministri i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë z. Ilir Bejtja, u përzgjodh kryetari i ri i MSG.

Në vlerësim të afateve lidhur me prodhimin e raportit EITI 2011 dhe fondeve në dispozicion, kryetari i ri i MSG-së z. Bejtja, paraqiti pranë Bordit Ndërkombëtar EITI kërkesën për zgjatjen e afatit për publikimin e raportit EITI 2011 deri më 30 Qershor 2014. Në dhjetor 2013 Znj. Dorina Çinari caktohet drejtuesja e re e Sekretariatit Shqiptar EITI.

Krahas interesit të vendeve të ndryshme Europiane për të zbatuar EITI-in, një delegacion nga Qeveria e Kosovës erdhi në Tiranë duke e pare eksperiencën shqiptare si një shembull të mirë për tu ndjekur ndaj nismës EITI.

2 *Vlerësimi i performancës kundrejt objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në planin e punës*

Plani i Punës EITI 2013, u mbështet në pesë objektiva kryesore. Për realizimin e objektivave EITI për vitin 2013, Sekretariati Shqiptar EITI ndërmorri aktivitete, kryesisht të dedikuara në zonat e industrisë nxjerrëse për të nxitur impaktin EITI:

2.1 Objektivi 1: Anëtarësimi dhe vazhdimësia e Shqiperisë në strukturën ndërkombetare EITI

Aktiviteti i Sekretariatit dhe MSG. Në vijim të angazhimit për antarsim, pasi vlerësoi performance e Sekretariatit Shqiptar EITI nëpërmjet publikimit të raporteve të para EITI

2009 dhe EITI 2010, dhe proçesin e pare të Validimit 2011, Bordi Ndërkombëtar EITI, e shpalli Shqipërinë më 2 maj 2013 “Vend Zbatues EITI”.

Gjatë Vitit 2013 veprimtaria e MSG është shënuar me këto aktivitete:

- Mbledhja e datës 13 mars 2013 ku u diskutua dhe u vendos mbi raportin vjetor të punës së EITI Albania 2012; u analizuan diferencat dhe problemet e dala nga Raporti EITI 2010; analize e kompanive që nuk deklaruan sipas rregullave për Raportin EITI 2010; u miratua plani i punës EITI Albania për vitin 2013.
- Mbledhja e datës 17 prill 2013 u diskutua mbi draft vlerësimin e Sekretariatit Ndërkombëtar EITI për Shqipërinë.
- Mbledhja e datës 20 nëntor 2013 u miratua kërkesa dhe letra zyrtare nga MSG, drejtuar Sekretariatit Ndërkombëtar EITI për shtyrjen e afatit të publikimin të Raportit EITI 2011 mbi argumentin e paraqitur për situatën institucionale dhe ekonomike në Shqipëri në 6 mujorin e dytë 2013. Gjithashtu u bë e mundur koordinimi midis Ministrisë së Financave dhe Bankës Botërore për miratimin e projektit grand "Mbështetje për zbatimin e EITI ne Shqiperi për periudhën 2014-2015' dhe koordinimi i punës për TOR të Raportit EITI 2011 dhe 2012 me Sekretariatin Ndërkombëtar EITI dhe Bankën Botërore.

Përfshirja e grupeve të interesit. Për të përmbushur objektivin e vazhdimësisë së Shqipërisë në strukturën ndërkombëtare, MSG vlerësoi të rrisë numrin e përfaqësuesve nga komunitetet dhe pushteti vendor si vëshgues në mbledhjet e saj. MSG i drejtoi kërkesë institucioneve të pushtetit lokal Bulqizë dhe Patos si qendra kryesore të industrisë nxjerrëse minerare dhe naftës.

2.2 Objektivi 2: Raporti EITI për vitin 2011

Raporti EITI nuk mundi të publikohej brënda vitit 2013. Sekretariati Shqiptar EITI njoftoi Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe Bankën Botërore për aprovimin e menjëhershëm të marrëveshjes grant "*Mbështetje të Zbatimit Shqiptar EITI për periudhat 2014-2015".* Gjithashtu u përgatitën materiale për të kërkuar mbështetje financiare. Kjo mbështetje ju kërkua Bankës Botërore dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës në muajin prill 2013, institucione të cilat dhanë miratimin për mbështetjen financiare të projektit EITI. Draft marrëveshja për mbështetjen financiare nga Banka Boterore ju dërguar qeverisë shqiptare në gusht 2013 pranë Ministrisë së Financave, dhe si pasojë e ngrirjes administrative nuk u arrit të ekzekutohej.

Përgatitja dhe paraqitja e draftit për termat e references në MSG. Nëntor 2013 MSG diskutoi për here të pare Termat e Referencës për përgatitjen e Raporteve EITI 2011 dhe 2012. Në këtë kuadër dhe referuar rekomandimeve të paraqitura në Raportin EITI 2010 nga Fair Links mbi pragun e materialitetit, u dikutua rritja e pragut kufi të të ardhurave të kompanive nxjerrëse për deklarimet në raportin EITI 2011 nga 500 mije USD ne 750 mije USD deri në 1 milion USD.

Kërkesë për shtyrje afati të dorëzimit të raportit EITI 2011. Kryetari i MSG-së z. Ilir Bejtja, firmosi një kërkesë zyrtare për shtyrjen e afatit të publikimit të Raportit EITI 2011 dërguar Sekretariatit Ndërkombëtar EITI.

2.3 Objektivi 3: Ngritja e kapaciteteve

Pjesmarrja dhe eksperienca në aktivitetet ndërkombëtare e ndihmuan Sekretariatin Shqiptar EITI dhe MSG mbi rritjen e kapaciteteve të brendëshme në fushën e komunikimit, njohjes së specifikave në manaxhimin e industrive nxjerrëse dhe zbatimit të standarteve të reja EITI.

Më poshtë po listojmë aktivitete domethënëse:

. Seminari i organizuar nga GIZ Germany ne 23-25 Prill 2013 në lidhje me "Komunikimin EITI", *Talking Matters*, një udhëzues për të komunikuar Iniciativën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse. Në këtë takim morri pjesë znj. Arlinda Rumbullaku, Specialiste e Marrëdhënieve me Publikun në Sekretariatin Shqiptar EITI.

. Konferenca e 6 Globale EITI në Sydney, Australi, ishte pjesëmarrja e parë e Shqipërisë si një vend antar në EITI. Rëndësia e Konferencës së 6 Globale EITI ishte për të përmirësuar menaxhimin e industrisë nxjerrëse. Në këtë takim morrën pjesë, z. Neritan Alibali, Kryetari i MSG-së dhe zv. Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës; z. Shkëlqim Hysa, Drejtues i Sekretariatit Shqiptar EITI; z. Ilir Aliaj, përfaqësues i shoqërisë civile dhe antar i MSG-së; dhe z. Agim Shehu, koordinator ekonomik në Sekretariatin Shqiptar EITI.

. Pjesemarrja në takimin ndërkombëtar EITI ne Astana, Kazakistan Tetor 2013 mbajtur për zbatimin e standardeve te reja EITI 2013. Në këtë takim morrën pjesë z. Ramiz Balla, Drejtor i Drejtorisë së Politikave Minerare dhe antar i MSG-së; z. Sami Neza, përfaqësues i shoqërisë civile; dhe z. Agim Shehu, koordinator ekonomik në Sekretariatin Shqiptar EITI.

2.4 Objektivi 4: Shtrirja e impaktit EITI në Shqiperi, aktivitetet e komunikimit.

Sekretariati Shqiptar EITI për vitin 2013, në bashkëpunim me organizata të ndryshme ka organizuar aktivitete komunikimi, të cilat janë ndjekur me interes nga grupet e interesit, duke rritur në këtë mënyrë dhe impaktin EITI në Shqipëri.

. Takimi Dita e Biznesit Social, mbajtur me 22.1.2013, Tirane, organizuar nga YUNUS Social Business dhe Agjencia Nxitja e Biznesit Social. Ky takim i ka sherbyer bashkëpunimit me organizatat vendase dhe ndërkombetare që punojnë në mbështetje të zhvillimit të bizneseve sociale në rajonet e industrisë nxjerrëse dhe mbrojtjes së mjedisit.
. Simpozium mbi përgjegjësinë sociale të korporatave në industrinë nxjerrëse në Shqipëri, organizuar më datë 19.02.2013 nga METE në bashkëpunim me Ambasadën Kanadeze, Tiranë. Ky takim i shërbeu njohjes dhe zbatimit të proçesit EITI në Shqipëri dhe mundësisë së bashkëpunimit në këtë proçes me kompanitë e industrisë nxjerrëse në Shqipëri.
. Në periudhën mars – prill 2013, janë organizuar seminare informuese rreth nismes EITI dhe veprimtarisë se sekretariatit, në Kukës, Vlorë dhe Tiranë me kompanitë e industrisë nxjerrëse, shoqërinë civile, pushtetin lokal dhe median.
. Në prill 2013 u organizua nje aktivitet informues me nxënës së shkollave të mesme në Korçë, ku u shpërndanë dhe materiale promovuese

. Konferenca kombëtare e qershorit mbajtur më 05.06.2013 në Tiranë bëri të mundur vlerësimin e punës dhe rezultatet e anëtarësimit të Shqipërisë në EITI. Pjesëmarrës ishin përfaqësues nga pushteti qëndror, lokal, shoqëria civile, kompanitë dhe media.

. Seminar organizuar nga Projekti SNAP – SEE me 13.06.2013 në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit me synim bashkëpunimin dhe koordinimin e nevojshëm mes projekteve, institucioneve dhe vendeve të tjera ku problemet e transparencës në përgjithësi dhe të nismës EITI në veçanti kanë zënë vend të veçantë.

. Në fund të qershorit 2013, me kërkesë te Ambasadës Britanike në Tiranë, u zhvillua një takim me drejtuesin e Sekretariatit Shqiptar EITI, në lidhje me veprimtarinë e sekretariatit dhe nismës per transparence ne industrine nxjerrese në Shqipëri. Në këtë takim u diskutua mbi çështjen EITI dhe eksperiencën e përfituar në Shqipëri. Gjithashtu rëndësi ju dha diskutimeve për zhvillimin e mëtejshëm të EITI-it në kushtet e antarsimit të Shqipërisë në strukturën ndërkombëtare EITI dhe të koordinimit me vendet e tjera që mbështesin EITI-in. Palët shprehën gadishmërinë për të bashkëpunuar në drejtim të proçesit EITI.

- Pjesëmarrja në Forumin e 21-të OSCE për Ekonominë dhe Mjedisin, me 11-13 Shtator 2013, në Pragë, ku është diskutuar nga delegacioni shqiptar për zbatimin dhe aktivitetet e realizuara në Shqipëri rreth nismës EITI. Në mesin e vendeve të rajonit të Ballkanit, më 23-24 tetor, 2013, Sekretariati Shqiptar i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës organizoi një takim për të ndihmuar Republikën e Kosovës për të zbatuar iniciativën EITI. Takimi u mbështet, në eksperiencën shqiptare si një mundësi dhe si një shembull i mirë për tu ndjekur.
- Website. Publikimi i çdo aktiviteti të EITI Shqiptar në faqen zyrtare online. Përditësimi i vazhdueshëm i informacionit.

2.5 Objektivi 5: Aktivitete lidhur me sigurimin e fondeve

Për identifikimin e burimeve të qëndrueshme financiare për nismën EITI janë marrë kontakte dhe diskutuar me struktura dhe organizata ndërkombëtare dhe vendase si:

. Korespondecë zyrtare me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave për financim nga buxheti i shtetit.
. Korespondence me agjensitë teknike të ambasadave të huaja në Shqipëri si me Ambasadën Britanike dhe Ambasadën Kanadeze.
. Kërkesë për bashkëfinancim ndaj kompanive të mëdha të industrisë nxjerrëse minerare dhe hidrokarbure në Shqiperi si Bankers, Albpetrol, Beralba.
. Kërkesë për bashkëfinancim ndaj Bankës Botërore dhe OSCE Albania,

Kërkesave për bashkëfinancim ju përgjigjën pozitivisht Ministria e Ekonomise, Tregtisë dhe Energjisë duke rritur mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit për Sekretariatin Shqiptar EITI. Gjithashtu mbështetja e OSCE Albania ka qënë e konsiderueshme duke financuar kryesisht seminare në zonat e industrisë nxjerrëse. Ndërkohë mbështetësi kryesor për EITI vazhdon të jetë Banka Botërore nëpërmjet projektit "*Mbështetje të Zbatimit Shqiptar EITI për periudhat 2014-2015".* Marrëveshja e të cilit megjithë përpjektjet e Sekretariatit Shqiptar EITI nuk u arrit të nënshkruej brënda 2013 por u nënshkrua në fillim të vitit 2014.

3 *Vlerësimi i performancës kundrejt kërkesave EITI*

Sekretariati Shqiptar dhe MSG u njohë me Standartin e Ri EITI 2013, në muajin qershor të po këtij viti dhe u përqëndrua në përmirësimin e punës për publikimin e të dhënave të regjistrimit të lejeve minerare dhe të kontratave, në menaxhimin e të ardhurave nga industria nxjerrëse siç është grumbullimi dhe shpërndarja së rentës minerare në zonat e industrisë nxjerrëse përfituese. Ky informacion do të përmirësojë cilësinë e raporteve në të ardhmen dhe në rritjen e aksesit ndaj të dhënave. Për sa më sipër është fokusuar në njohjen e rentës minerare të shpërnadarë në disa komuna përfituese nga renta në industrinë nxjerrëse, në përmirësimin e draft termave të references për raportin e ri EITI 2012 dhe përmirësimin e planit të punës për vitin 2014.

Vlerësimi i kërkesave EITI:

Kërkesa:	Progresi:
1. Transparenca me kontratat, njohja dhe publikimi i kontratave të sektorit minerar (Kërkesa 3.12)	MSG ka diskutuar në takimet e saj lidhur me këto kërkesa, por gjithçka ka mbetur në kuadrin e diskutimeve.
2. Menaxhimi i të ardhurave, grumbullimi dhe shpërndarja e rentës minerare (Kërkesa 3.7 - 3.8)	MSG ka diskutuar në takimet e saj lidhur me këto kërkesa, por gjithçka ka mbetur në kuadrin e diskutimeve.

4 *Përmbledhje e përgjigjeve të MSG për rekomandimet nga rakordimi dhe validimi, nëse është e aplikueshme*

Rekomandimet nga Raporti EITI 2010 janë diskutuar nga MSG si;

Rekomandim 1. Përqendrimi tek tatim paguesit e mëdhenj. Raportet EITI janë vlerësuar nga MSG dhe është arritur në përfundimin se raportet vjetore duhet të përqëndrohen tek tatim paguesit më të mëdhenj të kompanive nxjerrëse.

Rekomandim 2. Rritja e pragut kufi të pagesave dhe të ardhurave të kompanive deklaruese për raportin EITI. Nëntor 2013 MSG diskutoi për rritjen e pragut kufi të të ardhurave të kompanive nxjerrëse për deklarimet në raportin EITI 2011 nga 500 mije USD ne 750 mije USD deri në 1 milion USD.

*Rekomandim 3. Deklaratat e njëanshme për operatorët e vegjël***.** Referuar rekomandimit të bërë në raportin EITI 2010, për mundesinë e kalimit tek deklaratat e njëanshme për operatoret e vegjël, eshte vleresuar nga MSG si jo e pershtatshme dhe është vendosur se për të rritur transparencen në industrinë nxjerrëse në Shqiperi është e nevojshme që edhe për operatoret e vegjël të kemi raportime të dy anshme.

Rekomandim 4. Përmirësim i dhënies së informacionit nga agjencitë shtetërore. AKBN, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kanë përmirësuar informacionin dhe monitorimin e treguesve ekonomike lidhur me taksat që mblidhen nga industritë nxjerrëse. Analiza dhe raporte vjetore më të detajuara janë paraqitur për vitin 2013 duke u bazuar ne studimet qe janë bere lidhur me shpërndarjen e kompanive te industrisë

nxjerrëse në territorin e vendit sipas mineralit, sipas nivelit të të ardhurave dhe sipas numrit te kompanive.

Rekomandim 5. Caktim formal i një pike kontakti EITI për çdo agjensi përkatëse shtetërore. Për vendosjen e bashkëpunimit mes MSG, agjensive shtetërore dhe kompanive të mëdha janë vendosur pika kontakti, të cilët janë ftuar në takime e seminare EITI për tu njohur me rregullat, proçedurat, treguesit dhe formularet EITI.

Rekomandim 6. Komunat dhe bashkitë, të cilat mbledhin kontribute fiskale nga kompanitë nxjerrëse duhet të perfshihen në raportet e ardhshme EITI. Lidhur me mirëqeverisjen e pushtetit vendor dhe të koordinimit me pushtetin qëndror për kontributet që mblidhen nga kompanitë nxjerrëse, është vlerësuar qe komunat dhe bashkitë kryesore që mbledhin kontribute fiskale nga kompanitë nxjerrëse te zonës (pushteti vendor) të raportojnë për këto të ardhura.

Rekomandim 7. Në lidhje me kontributin fiskal të kompanive nxjerrëse te autoritetet lokale mund të proçedohet raportimi përmes deklaratave te njëanshme. Për të qene më transparent në deklarimet për kontributin fiskal të evidentuara dhe rakordimet e tyre mes pushtetit vendor dhe kompanive nxjerrëse, MSG ka vlerësuar raportimin dhe rakordimin nga të dy palët deklaruese.

Rekomandim 8. Perfshirja e dividentit si burim të ardhurash. Dividendi veçanërisht në sektorin hidrokarbur është një tregues i rëndësishëm për burimin e të ardhurave që grumbullohet në sektorin e industrisë nxjerrëse dhe si i tillë është përfshirë në treguesit e pagesave që kryen dhe në një formular të veçantë deklarimi për raportet EITI.

Rekomandim 9. Miratimi i deklaratave të kompanive nga auditorë të jashtëm. Të gjitha kompanitë deklaruese të industrisë nxjerrëse (të mëdha, të mesme dhe të vogla) duhet të paraqesin deklarimet e tyre të miratuara jo vetëm nga administratorët por edhe nga auditorët e tyre të jashtëm.

Rekomandim 10. Përfshirja në raportet EITI e kompanive që kryejnë negociata me shtetin dhe paguajnë bonuse nënshkrimi. Lidhur me këtë rekomandim MSG ka vendosur për të përfshirë në raportet EITI të gjitha kompanitë e naftës dhe gazit përfshirë dhe ato që kanë qenë ne negociata dhe kanë paguar Bonuse të Nënshkrimit.

5 *Ndonjë pikë e fortë ose dobësitë e identifikuara në proçesin EITI*

Strengths

- Shumë çështje ndaj proçesit EITI janë zgjidhur në mënyrë transparente ndaj çdo propozimi të bërë nga shoqëria civile, kompanitë dhe qeveria, anëtar në Bordin EITI. Çështje si: Diskutimi për transparencën e kontratave në Industrinë Minerare; Grumbullimi dhe shpërndarja e informacionit për përdorimin e rentës minerare.
- Ndërgjegjesimi publik mbi transparencën në industrinë nxjerrese kryesisht në zonat minerare është rritur ndjeshem. Vihet re në të gjitha takimet e zhvilluara me perfaqesues të grupeve të interesit, se tanimë janë të vetëdijshëm mbi kontributin dhe në të drejtat e komuniteteve.

Weaknesses

- Buxheti 2013 i papërcaktuar. Është me rëndësi që Sekretariati Shqipëria EITI të ketë një shifër të qartë të buxhetit, që është jetike për planifikimin e strukturës dhe frekuencën e aktiviteteve. Veprimtaria e sekretariatit është e varur direkt nga fondet që vinë nga donatorët, ku në raste mungese të donacioneve shumë aktivitete EITI mbeten pezull.
- Mospërgatitja dhe publikimi i raportit 2011 brënda vitit 2013.

. Ndikimi i lartë që ka politika në shoqëri, si psh zgjedhjet e vitit elektoral 13, të cilat ndikuan dhe në veprimtarinë e Sekretariatit Shqiptar EITI.

6 *Kostoja totale e implementimit*

Viti 2013 për Sekretariatin Shqiptar EITI u mbulua nga fondet e Buxhetit të Shtetit, fonde të cilat shkuan për shpenzime operacionale dhe pagat. Financimi nga Buxheti i Shtetit për vitin 2013 për Sekretariatin Shqiptar EITI ishte në nivelin e 7.6 milion Leke (rreth 76 mije $) me një rritje 26 % kundrejt vitit 2012. Grandi i Bankës Botërore si mbështetje financiare për realizimin e Raportit EITI 2011 nuk u arrit të realizohej brenda vitit 2013. Struktura organizative e Sekretariatit Shqiptar EITI për vitin 2013 ka qënë e miratuar nga Ministria e Ekonomise, Tregtisë dhe Energjitikës me 9 (nëntë) punonjës. Ndërkohë stafi faktik i Sekretariatit Shqiptar EITI për periudhën 2013 ka qënë me 6 (gjashtë) punonjës. Mbështetje financiare ndaj aktiviteteve të Sekretariatit ka dhënë prezenca e OSBE në Shqipëri. Më poshtë do gjeni një informacion të detajuar për buxhetin e viti 2013.

Totali	**Në Lekë**
Në dispozicion	8,248,000.00Lek
Përdorur gjatë vitit (ose 98%)	7,661,000.00Lek
Fondi Buxhetor	
Parashikimi	7,679,000.00Lek
Realizuar (ose 98.2%)	7,542,000.00Lek
Fonde nga Donatorët(Albpetrol)	

Parashikimi	569,000.00Lek
Realizuar	119,000.00Lek

Përdorimi i fondeve

Fondi i Detajuar Sipas Zërave	**Në Lekë**
A. Pagat	
Parashikimi	5,132,000.00Lek
Realizuar (ose 98.1%)	5,035,000.00Lek
B. Sigurimet	
Parashikimi	2,364,000.00Lek
Realizuar (ose 98.3%)	2,324,000.00Lek
C. Shpenzimet të tjera Operative	
Parashikimi	183,000.00Lek
Realizuar (ose 100%)	183,000.00Lek

7 Ndonjë koment shtesë

Si rrjedhojë e mungesës së fondeve aktivitetet EITI 2013, u shtynë për tu përmbushur për në vitin 2014. Thirrjes nga ana e Sekretariatit Shqiptar EITI dhe MSG për financim gjatë 2014 i janë përgjigjur një numër i operatorësh të cilët kryenë aktivitet në Shqipëri. Duhet theksuar se fondi i dhënë nga buxheti i shtetit për vitin 2014 është në nivelin e 10 milion leke (rreth 100 mijë $) duke patur një rritje me 33% mbi buxhetin e vitit 2013. Objektivat kryesore për vitin 2014 janë realizimi dhe publikimi i dy raporteve EITI 2011 dhe 2012 sipas Standarteve të Reja EITI.

8 Është diskutuar veprimtaria e raportit përtej MSG-së

Në përgatitjen e këtij Annual Activity Report 2013 u disktutua me anëtarët e MSG, mbi sygjerimet e ndryshme nga shoqëria civile, kompanitë dhe qeveria.

9 Detaje mbi antarësinë e MSG gjatë periudhës

Gjatë vitit 2013 MSG zhvilloi tre mbledhje. Ky grup, deri në muajin nëntor 2013 drejtohej nga zëvendësministri i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, z. Neritan Alibali. Në nëntor, kryetar i ri i Bordit EITI u vendos zëvendësministri i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë z. Ilir Bejtja.

Antarët e Grupit Ndërinstitucional i Punës:

Antarët e qeverisë (7 përfaqësues)

Kryetari i Grupit Ndërinstitucional i Punës, Ministria e Energjisë dhe Industrisë

Një përfaqësues nga Ministria e Financave

Një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë

Një përfaqësues nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë

Një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

Një përfaqësues nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Antarët e Shoqërisë Civile (5 përfaqësues)

Qëndra për zhvillim dhe Demokratizim të Institucioneve

Qëndra Shqiptare për Zhvillim Institucional

Qëndra për Transparencë dhe Informim të Lirë

Youth media Albania

Qëndra Shqiptare për të Drejtat Ndërkombëtare

Bisnesi (4 përfaqësues)

Bankers Petroleum

AlbPetrol

FIAA

Stream Oil

Petromanas

Takimet e MSG

Datë 13.03.2013: MSG diskutoi mbi këto çështje:

. Raporti vjetor i punës së EITI Albania 2012
. Analizimi i diferencave dhe problemeve të dala nga Raporti EITI 2010
. Masat ndaj kompanive që nuk deklaruan sipas rregullave për Raportin EITI 2010
. Plani i punës së EITI Albania për vitin 2013

Datë 17.04.2013: MSG diskutoi mbi këto çështje:

. Draft vleresimin e Sekretariatit Nderkombetar EITI per Shqiperine

Datë 20.11.2013: MSG diskutoi mbi këto çështje:

. Të miratojë kërkesën dhe letrën zyrtare nga MSG, drejtuar Sekretariatit Ndërkombëtar EITI për shtyrjen e afatit të publikimin të Raportit EITI 2011 mbi argumentin e paraqitur për situatën institucionale dhe ekonomike në Shqipëri në 6 mujorin e dytë 2013.
. Koordinim midis Ministrisë së Financave dhe Bankës Botërore për miratimin e projektit grand "Mbështetje për zbatimin e EITI ne Shqiperi për periudhën 2014-2015'
. Koordinimi i punës për TOR të Raportit EITI 2011 dhe 2012 me Sekretariatin Ndërkombëtar EITI dhe Bankën Botërore.

E aprovuar nga MSG:

Datë:

Shtojcë: Foto të aktiviteteve të EITI-it Shqiptar në 2013

***Kosova interesohet për nismën EITI**. Një grup pune nga qeveria e Kosovës dhe Sekretariatit Shqiptar EITI, më 23-24 tetor zhvilluan një takim të përbashkët për të ndihmuar Republikën e Kosovës për të zbatuar iniciativën EITI.*

Implementimi i Standartit të ri EITI në 2014. *Më 7-9 tetor 2013 në Astana, Kazakistan, Sekretariati Ndërkombëtar EITI dhe Banka Botërore organizuan një workshop mbi Standartet e Reja EITI.*

Konferenca Shqipëria vend antar në EITI. *Më 2 maj 2013, Shqipëria shpallet vend antar në Nismën EITI. Sekretariati Shqiptar EITI organizoi një conference në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë*

Konferenca e 6-shtë Globale EITI në Sidnej. *Rëndësia e Konferencës së 6 Globale EITI ishte për të përmirësuar menaxhimin e industrisë nxjerrëse dhe Shqipëria merr pjesë si një vend antar në EITI.*

Seminar mbi rëndësinë e komunikimit në EITI. *23-25 prill në Gjermani u zhvillua seminari për rëndësinë që ka komunikimi në nismën EITI dhe transparencën.*

Seminar në Kukës.

Sekretariati Shqiptar EITI më 25 prill 2013 zhvillon një seminar mbi rritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe të kuptuarit e iniciativës EITI.

Seminar në Vlorë

Sekretariati Shqiptar EITI më 28 mars 2013 zhvillon një seminar mbi rritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe të kuptuarit e iniciativës EITI.

Seminar në Pogradec

Sekretariati Shqiptar EITI më 19 mars 2013 zhvillon një seminar mbi rritjen e nivelit të bashkëpunimit dhe të kuptuarit e iniciativës EITI.